



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Event Sportiv të organizuara nga "Ekipet Sportive në Shkollë"
"Akomodim për nxënësit dhe trajnerët në Qarkun e Vlores sipas kalendarit të miratuar".

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar	2
3. Çfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit	6
9. Procesi i Vlersimit	6
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë evente sportive, ndeshjet në bashki, ndeshjet në nivel qarku, dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit për periudhën 01.03.2024 - 15.06.2024 sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo event që do të organizohet.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/ekipet/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr.	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim/Njësi	Vlera/Lek	Burimi i Financimit	Kohezgjatja
1	Organizim eventit kulturor sportiv.	Akomodim për nxenesit dhe trajnerët në Qarkun e Vlores sipas kalendarit të miratuar	Organizim Eventit Sportiv	Dite	Max 3,000 leke Fjetja/person Max 1,000 leke Darka/person	Fondi limit 150,000 leke pa Tvsh	Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive në Shkollë”.	1 ditë në 1 qark të caktuar sipas kalendarit të ndeshjeve të miratuara nga Ekipet Sportive.

4. Metodologjia dhe plani i punës

Do të kontaktohet individ/ekip/kompani i cili do të propozojë ofertën më të mirë për kryerjen e organizimit të eventit sportiv.

Qëllimi i akomodimit: Sigurimi i një nate qëndrimi për fëmijët, trajnerët dhe koordinatorët e shkollave të përfshira në event.

Numri i pjesëmarrësve: 30 persona

Kërkesa për shërbime: Akomodim në kushte të përshtatshme për fëmijë dhe të rritur.

Mëngjes i përfshirë në çmim.

Ambient i sigurt dhe pranë vendit ku do zhvillohet eventit.

5. Kualifikimet e nevojshme

Kualifikimet:

- Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë në fushën e shërbimeve të kërkuara.
- Të ketë eksperiencë të mëparshme për organizimin e eventeve të ngjashme kulturore dhe sportive.
- Të ketë infrastrukturen e nevojshme për organizimin e shërbimit të eventit të ngjarjes sportive.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

- Te ofroje shërbimin e kërkuar sipas kërkesave nga KOKSH.
- Te paraqese ofertën sipas kërkesës nga ne.

6. Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare për event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresën e saktë.

7. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

8. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 25.03.2024 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

9. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Eksperiencat e punës/CV e firmës/individit	20%
Eksperience në organizim eventesh të ngjashme.	40%



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Staf dhe paisjet teknike te nevojshme per organizimin e eventit.	40%
--	-----

10. Informacion nese eshte perdorur njoftim paraprak.

Nuk eshte perdorur njoftim paraprak ne lidhje me kete lloj sherbimi te kerkuar.